



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:233696

Datë: 05.01.2023

Numri i dokumentit: 03827345

P.nr 253/21

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA KLINË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurit A (A) H nga fshati D K.Kline për shkak të veprës penale “Uzurpim i pronës së paluajtshme” nga neni 320 par 1 të KPRK-se duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-së nga Peja PP/II.1791/2021, dt.17.10.2021, në bazë të nenit 358 paragraf 1. nën par.1.2 të KPPK-ës, dhe nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës jashtë shqyrtimit gjyqësorë me dt.05.01.2023, maur këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e arritur në ndërmjetësim nr. Nd. nr.09/2022 e dt. 22.11.2022 në mes të pandehurit A H nga fshati D K.Kline, dhe përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit Gj G Av V H nga Ferizaji në një të anë dhe i dëmtuari Gj G.

HUDHET AKTAKUZA, PP/II.1791/21, dt.17.10.2021, kundër të pandehurit A H nga fshati D K.Kline, për shkak të veprës penale “Uzurpim i pronës së paluajtshme” nga neni 320 par 1 të KPRK-se duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-së nga Peja PP/II.1791/21, dt.17.10.2021. Për shkak se prokurori me shkresën PP/II.1791/2021 të dt.21.12.2022, e ka tërhequr aktakuzën, PP/II.1791/2021 të dt.21.12.2022 me arsye se palët ndërgjyqese në rastin konkret, në procedurë të ndërmjetësimit kanë arritur marrëveshje dhe pajtim në mes veti. me nr.ND.09/2022 me dt.22.11.2022.

PUSHOHET procedura penale në çështjen penale PP/II.1791/21, dt.17.10.2021, kundër të pandehurit A H nga fshati D K. Klinë, për shkak të veprës penale Uzurpim i pronës së

paluajtshme nga neni 320 par 1 te KPRK-se, sepse prokurori me shkresën PP/II.1791/2021 te dt.21.12.2022 e ka njoftuar Gjykatën se e ka tërhequr aktakuzën PP/II.1791/2021.

A r s y e t i m

Numri i lëndës: 2021:0066816 Datë: 17.10.2021 Numri i dokumentit: 01564562 Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë, me PP//nr.1791/2021, kundër të pandehurit A H nga fshati D K.Kline, për shkak te veprës penale Uzurpim i prones se paluajtshme nga neni 320 par 1 te KPRK-se.

Gjykata në bazë nenit 232 të KPPK-ës, nenit 2 paragraf 2, nenit 8 lidhur me nenin 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, udhëzuesit për lëndët e gjykatave të përshtatshme për ndërmjetësim i nxjerr nga këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër protokolli 01/66 i dt.29.01.202, e ka referuar rastin për ndërmjetësim.

I pandehuri A H nga fshati D K.Kline, dhe përfaqësuesja e autorizuar e pales së dëmtuar V H av nga Ferizaji, në anën tjetër është arritur marrëveshje përmes procedurës së ndërmjetësimit me nr nr. Nd. nr.09/2022 e dt. 22.11.2022.

Prokurori shtetit duke u bazuar në marrëveshjen e arritur në nr.ND.09/2022 me dt.22.11.2022. të arritur në mes të palëve me shkresën penale PP/II.1791/21, dt.17.10.2021 e ka njoftuar me shkrim Gjykatën se e ka tërhequr aktakuzën PP/II.1791/21, dt.17.10.2021.

Gjykata në bazë te nenit 15 të ligjit për ndërmjetësim te Kosovës e ka aprovuar marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim ne mes te pandehurit A H nga fshati D K.Kline, dhe përfaqësuesja e autorizuar e pales së dëmtuar av. V H nga Ferizaji, në anën tjetër është arritur marrëveshje përmes procedurës së ndërmjetësimit me nr nr. Nd. nr.09/2022 e dt. 22.11.2022, kane arritur marrëveshje përmes procedurës së ndërmjetësimit me nr. Nd nr.09/2022 e dt. 22.11.2022.

Gjykata bazë të nenit 358 paragraf 1. nën par.1.2 të KPPK-ës, nenit 232 të KPPK-ës, nenit 2 paragraf 2, nenit 8 lidhur me nenin 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, udhëzuesit për lëndët e gjykatave të përshtatshme për ndërmjetësim i nxjerr nga këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër protokolli 01/66 i dt.29.01.202, jashtë shqyrtimit gjyqësorë me dt.14.12.2022 ka vendosur si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA KLINË

P.nr.253/2021 te dt. 05.01.2023

Zyrtare ligjore
Liridona Palushi

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankese në afat prej tre dite drejtuar gjykates se Apelit, ndërmjet kesaj gjykate.